



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __. __. 2018

V E N D I M

Nr. 242 , Datë 27 / 11 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.78 regj., datë 30.05.2018 të znj.D. P, kundër Administratorit të Universitetit të Tiranës (UT), me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes familjare” dhe “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në dokumentacionin e administruar nga Komisioneri, rezulton se znj.D. P është në marrëdhënie pune me Universitetin e Tiranës (UT) prej më shumë se 24 vitesh. Fillimisht ka punuar si Specialiste pranë Rektoratit të UT-së. Më pas, me Vendimin nr.70, datë 17.04.2000 të Rektorit të UT-së është emëruar në detyrën e Kryetares së Degës së Personelit dhe Organizimit. Pas ndryshimeve të ndodhura në strukturën organizative të Rektoratit të UT-së, Dega e Personel-Organizimit ka ndryshuar emërtesën në “Drejtori e Burimeve Njerëzore” dhe ankuesja bazuar në Vendimin nr.103, datë 05.06.2008 të Rektorit të UT-së “Për miratimin e organikës analitike të Rektoratit të UT-së” është emëruar Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNJ), detyrë të cilën e ushtron dhe aktualisht.

¹ Tek “çdo shkak tjetër” ankuesja ka argumentuar lidhur me konfliktin e krijuar mes ish-Kancelarit dhe më pas Administratorit aktual të UT-së, lidhur me pretendimin për kompetencat e katij të fundit dhe Rektorit të UT-së. Ky konflikt ka përfshirë edhe subjektin ankues, duke e presupozuar atë si përkrahëse të Rektorit.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

Znj.D. P shprehet se ka ushtruar me dinjitet dhe seriozitet maksimal detyrën e saj dhe se asnjëherë gjatë 24 viteve punë pranë UT-së nuk i është tërhequr vëmendja për ndonjë parregullsi apo shkelje në detyrën që ajo ka ushtruar. Përkundrazi, është vlerësuar për punën, përkushtimin dhe etikën gjë të cilën e tregon dhe vazhimesia prej 10 vitesh në të njëjtën detyrë, si Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pavarësisht ndryshimit të titullarëve të institucionit ndër vite.

Znj.D. P parashton se, ajo ka vijuar e qetë punën deri në datën 1 Gusht 2017, datë në të cilën ish-Kancelari i UT-së, në abuzim të plotë me detyrën dhe në tejkallim të kompetencave tij nxori Urdhërin nr.8, datë 01.08.2017 “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës”, duke urdhëruar zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës së ankueses me UT-në. Në kushtet kur ky urdhër ishte nxjerrë nga një person që nuk kishte asnjë tagër ligjor për lidhjen apo zgjidhjen e marrëdhënies të punës, Rektori I UT-së nxori Urdhërin nr.25, datë 23.08.2017 “Për moszbatimin e Urdhërit nr.8, datë 01.08.2017, të Kancelarit të UT-së”. Ndërkaq, pas urdhërit të Rektorit, ankuesja ka vijuar të ushtrojë detyrat dhe funksionet e saj si Drejtore e DBNJ pranë Rektoratit të UT-së, provuar dhe nga praktikatat e ndjekura në kuadër të DBNJ-së të ndodhura pranë Zyrës së Protokoll Arkivës, si dhe nga Listë prezencat përkatëse.

Znj.D. P shprehet se nga data 5 Shtator 2017 e në vijim nuk është paguar për punën e kryer dhe shkak për moskryerjen e pagesës ka qenë ish-Kancelari i UT-së, i cili në cilësinë e nëpunësit autorizuaes për Rektoratin e UT-së nënshkruante urdhër shpenzimet e pagave të punonjësve. Në këto kushte, ankuesja pretendon se është ndodhur në një situatë të padrejtë, diskriminuese, për shkak të trajtimit të pabarabartë në raport me punonjësit e tjerë.

Me Vendimin nr.26, datë 07.12.2017 të Bordit të Administrimit është emëruar z.S. D në detyrën e Administratorit të UT-së³. Znj.D. P shprehet se z.S. D përveçse nuk e ka paguar për punën e kryer, ka ndërmarrë ndaj saj edhe veprime të tjera diskriminuese, duke cituar se:

Administratori e ka përjashtuar atë edhe nga pagesa për punën e kryer si anëtare e Komisionit të Zgjedhjeve në Institucion (zgjedhjet e pjesshme të zhvilluara me datë 4 Dhjetor 2017 në UT) në një kohë kur të gjithë anëtarët e tjerë janë paguar.

Po ashtu, Administratori e ka përjashtuar edhe nga lista e punonjësve që kanë marrë shpërblim për punën e kryer në vitin 2017.

Ankuesja shprehet se me veprimet e tij ndaj saj, Administratori kishte për qëllim të vështirësonte dhe pengonte ushtrimin e detyrës nga ana e saj, duke cituar se: “...konkretisht, veprimi i tij degjeneroi në një akt të turpshëm vetëgjyqësie dhe arbitrariteti, duke ndërruar bravën e derës së zyrës së DBNJ ku unë ushtroja detyrën. Për këtë akt, ndaj z.S. D është regjistruar një procedim penal lidhur me kallëzimin nr.17184, datë 27.12.2017, fakt ky i provuar me Vendimin nr.1260,

³ Detyrë të cilën e mbante më përpara z.R. S, si Kancelar i UT-së.

datë 12.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Z.S. D nuk është ndalur vetëm në këto sjellje dhe veprime ndaj meje. Për shkak të gjendjes sime familjare (si grua, kryefamiljare, pa përkrahje) ka përdorur forcat e policisë private, për të mos lejuar hyrjen time në institucion për dy muaj me radhë. Detyrën time gjatë kësaj kohe e kam ushtruar nga shtëpia, në kushte të rënda psikologjike dhe materiale. Për shkak të urdhërave të tij të paligjshëm dhënë rojeve private të institucionit për ndalimin e hyrjes time në vendin e punës, unë jam bërë edhe subjekt artikujsh të mediave të ndryshme online, duke më cënuar dinjitetin dhe moralin tim”.

Znj.D. P shprehet se i është bërë dorëzimi i çelësit të zyrës së saj me anë të një procesverbali, nga ana e grupit të punës, ngritur nga Administratori. Ajo vijon duke parashtruar se, ndonëse vijon të ushtrojë punën e saj normalisht, nga ana e Administratorit vazhdon të mos paguhet dhe t’i bëhet presion se ajo është punonjëse e paligjshme në institucion, ndërkohë që ka urdhër të Rektorit të UT-së dhe një vendim gjykate të formës së prerë⁴, lidhur me ligjshmërinë e qëndrimit të saj në detyrë.

Për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje, ankuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me Vendimin nr.2028, datë 05.03.2018 ka vendosur deklarinimin e pavlefshmërisë absolute të urdhërit të nxjerrë nga Kancelari, si dhe detyrimin e UT-së për t’i paguar të gjitha pagat.

Në përfundim të ankesës së saj, znj.D. P kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit nga ana e Administratorit, marrjen e masave për ndalimin e shqetësimit të saj në vendin e punës, si dhe të mos i cënohen të drejtat me karakter financiar si nëpunëse e Rektoratit të UT-së.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁴ Vendim nr.2028, datë 05.03.2018 I Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë me datë 20.03.2018 pasi nuk është ankimuar.

Neni 7 i LMD-së⁵, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

1. Me shkresën me nr.783/1 prot., datë 11.06.2018 i është kërkuar informacion Administratorit dhe Rektorit të UT-së, lidhur me pretendimin e znj.D. P.

Me shkresën me nr.2960/1 prot., datë 21.06.2018 Administratori i UT-së ka informuar Komisionerin se, një ndër detyrat me të cilat Bordi i Administrimit ka ngarkuar Kancelarin, ka qenë edhe administrimi i personelit administrativ, si dhe nënshkrimi i kontratave të punës me ta, pas miratimit të pozicioneve të punës dhe kriterëve nga Bordi. Gjatë periudhës që ka qenë i ngarkuar me detyrat e Administratorit, ai ka konstatuar shkelje të rënda në detyrë të kryera nga ankuesja, të cilat i ka cituar në shkresë, dhe në disa raste ajo ka zbatuar urdhëra të paligjshëm të Rektorit të UT-së, lidhur me vendosjen në listë prezence të punonjësve të cilët nuk kanë qenë në vendin e punës (gjatë periudhës së paguar) apo përmes punësimeve të kryera në Rektoratin e UT-së⁶.

- Me shkresën nr.71/7, datë 10.05.2017 ish-Kancelari i ka dhënë asaj masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”.
- Me shkresën nr.192 prot, datë 12.07.2017 ish-Kancelari ka kërkuar nga ankuesja fillimin e procedurave për punësimet sipas strukturave të reja të miratuara në Bordin e Administrimit. Ankuesja nuk ka pranuar të njohë dhe të zbatojë detyrat e ngarkuara nga ish-Kancelari.
- Duke qenë se shkeljet kanë vazhduar në vijimësi, Administratori shprehet se është bazuar në bazuar në Relacionin nr.199/1, datë 01.08.2017 ka nxjerrë Urdhërin nr.8, datë 01.08.2017 “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës” për ankuesen D. P, nga ana e ish-Kancelarit.
- Lidhur me pretendimin se ajo nuk trajtohet me pagë, Administratori parashtron se, znj.D. P nuk mund të trajtohet me pagë pasi për të ka një vendim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

⁵ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁶ Cituar në shkresën e sipërcituar të Administratorit të UT-së.

- Nga ana tjetër, për znj.D. P nuk ka asnjë vendim gjyqësor për kthim në punë, i cili të mund të ekzekutohet. Administratori shprehet se, çdo vendim i Rektorit për stafin administrativ nuk ka fuqi juridike, pasi Rektori nënshkruan kontratat e punës vetëm për personelin akademik dhe ndihmës akademik. Në këto rrethana, Administratori nuk ka legjimitetin të paguajë një person për të cilin ka largim nga puna.
- Lidhur me pretendimin e ankueses se nuk është paguar nga ana e Administratorit për punën e kryer si anëtare e Komisionit të Zgjedhjeve në Institucion, z.S. D shpjegon se, në zbatim të Vendimit nr.17, datë 10.07.2017 të Bordit të Administrimit, ai në cilësinë e nëpunësit autorizues, ka paguar të gjithë punonjësit pa përjashtim, përfshirë edhe sekretaren teknike, znj.D. P⁷.
- Lidhur me pretendimin e znj.D. P për përjashtimin e saj nga lista e punonjësve që kanë marrë shpërblim në vitin 2017, Administratori shpjegon se ankuesja nuk ka qenë e punësuar gjatë kësaj periudhe. Duke qenë se çështja po ndiqet gjyqësisht, z.S. D shprehet se janë në pritje të vendimit të gjykatës.
- Lidhur me pretendimin e ankueses për shqetësim në vendin e punës, z.S. D informon se znj.D. P nuk ka paraqitur asnjë ankesë as verbalisht, as me shkrim tek ai për këtë shkak dhe se një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Administratori thekson se nuk ka patur asnjë kontakt apo takim të drejtëpërdrejtë apo indirekt me znj.D. P, përveç tre takimeve në zyrën e tij, të kërkuara nga vetë ankuesja për të biseduar lidhur me largimin e saj nga puna. Sipas Administratorit ankuesja ka shfaqur qëndrime agresive, konfliktoze dhe hakmarrëse ndaj punonjësve të tjerë gjatë kësaj kohe.

Me shkresën nr.2960/2 prot., datë 26.06.2018, Rektori ka informuar Komisionerin se ka qenë në dijeni të mospagesës së ankueses për punën e kryer nga data 1 Shtator 2017 e në vijim, dhe ka përdorur të gjitha mjetet ligjore dhe rrugët zyrtare për zgjidhjen e kësaj çështjeje jetike për punonjësen.

- Nga ana tjetër, ky rast është ndjekur gjyqësisht nga ankuesja dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me Vendimin nr.2028, datë 05.03.2018 ka vendosur deklarinë e pavlefshmërisë absolute të urdhërit të nxjerrë nga Kancelari si dhe ka detyruar UT t'i paguajë znj.D. P pagat prej muajit Gusht 2017 e në vijim. Ky vendim ka marrë formë të prerë.
- Përmes kësaj shkrese, Rektori konfirmon dijeninë e tij lidhur me mospagesën e znj.D. P për punën e kryer si sekretare e Komisionit të Zgjedhjeve në zgjedhjet jashtë radhe të zhvilluara në UT në datën 4 Dhjetor 2017, si dhe përjashtimin e saj nga lista e punonjësve që kanë marrë shpërblim për punën e kryer gjatë vitit 2017.
- Po ashtu, Rektori i UT-së cilëson si të paprecedent rastin e znj.D. P, të cilës iu ndërrua brava e derës së zyrës dhe u porosit policia private për ta nxjerrë jashtë nga institucioni për dy muaj rresht. Lidhur me këtë fakt, Rektori informon se në cilësinë e titullarit të UT-

⁷ Sipas shkresës nr.3157/4 prot., datë 28.12.2017.

së, ka bërë kallëzim penal⁸ në polici ndaj z.S. D, për të cilin është regjistruar procedimi penal, fakt i provuar me anë të Vendimit nr.1260, datë 12.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Nëpërmjet kësaj shkrese, Rektori konfirmon se znj.D. P ka vazhduar të ushtrojë detyrat dhe kompetencat e saj çdo ditë, (edhe gjatë periudhës që është lënë jashtë institucionit ka vijuar punën nga shtëpia) pavarësisht pengesave të mëdha që i janë krijuar nga ana e Administratorit, shantazheve dhe intimidimeve.
 - Në përfundim, Rektori parashtron se znj.D. P është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me punonjësit e tjerë të cilët janë paguar rregullisht për punën e tyre, duke i cënuar kështu të drejtat me karakter financiar si nëpunëse e Rektoratit të UT-së, si dhe ato me karakter moral, shëndetësor etj.
2. Me shkresën me nr.783/4 prot., datë 20.07.2018 Komisioneri i ka këkuar informacion dhe dokumentacion provues Administratorit të UT-së, lidhur me ekzekutimin e Vendimit nr.2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për znj.D. P; si dhe lidhur me pagesën për pjesëmarrjen e saj në Komisionin për zgjedhjet e pjesshme të zhvilluara me datë 04.12.2017.

Nëpërmjet shkresës me nr.2960/4 prot., datë 26.07.2018 Administratori i UT-së ka informuar Komisionerin se në institucion nuk është paraqitur asnjë vendim i formës së prerë për ekzekutim të detyrueshëm sipas ligjit. Lidhur me këtë, ai shprehet se në momentin që do paraqitet vendimi i formës së prerë, ai do të ekzekutohet sipas dispozitave procedurale civile në fuqi.

Sa i takon pjesëmarrjes së ankueses në KIZ (Komisionin Institucional të Zgjedhjeve), z.S. D shprehet se ajo nuk është anëtare e KIZ, por sekretare teknike e tij dhe pagesa është realizuar referuar shkresës me nr.3157/4 prot., datë 28.12.2017.

Nëpërmjet shkresës me nr.2960/5 prot., datë 27.07.2018 Rektori i UT-së ka bashkëlidhur Vendimin nr.2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është vendim i formës së prerë. Lidhur me sa më sipër, ai shprehet se vendimi ende nuk është zbatuar nga ana e Administratorit.

- Lidhur me faktin e mospagesës së znj.D. P për pjesëmarrjen e saj në KZ për zgjedhjet e zhvilluara me datën 7 Dhjetor 2017, Rektori ka bashkëlidhur kopje të dy praktikave të mbajtura⁹, nga të cilat rezulton se:
- Nga praktika me nr.3157 prot., datë 19.07.2017 vërtetohet se me shkresën me nr.3157/4 prot., datë 28.12.2017, është kryer pagesa për znj.D. P për punën e kryer në KIZ në muajin Shkurt 2017, pagesë kjo e kryer pas 6 muajve.

⁸ Referuar kallëzimit penal nr.17184, datë 27.12.2017.

⁹ Kopje të praktikave ndodhen të depozituara në dosjen e ankueses, në cilësi prove.

- Nga praktika me nr.5080 prot., datë 12.12.2017 vërtetohet se megjithëse znj.D. P është listuar në listën e anëtarëve të KZ në shkresën me nr.73 prot., datë 12.12.2017 të KIZ, ajo nuk është paguar për punën e kryer deri tani.

Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr.2960/6 prot., datë 02.08.2018, Administratori i UT-së ka informuar Komisionerin se: *“Me shkresën nr.1136, datë 27.07.2018 të përmbaruesit gjyqësor privat është paraqitur lajmërimi për ekzekutim vullnetar të Vendimit nr. 2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për znj.D. P. Ky lajmërim është ekzekutuar sipas shkresës me nr.3664/1 prot, datë 31.07.2018 dhe Urdhër pagesës 265, datë 31.07.2018 të depozituara në Degën e Thesarit Tiranë”*. Bashkëlidhur është depozituar dokumentacioni provues me sa më sipër.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së znj.D. P, Komisioneri me datë 12.09.2018 realizoi një seancë dëgjimore¹⁰.

Në seancë ishin të pranishëm përfaqësues të të dyja palëve në proces. Administratori i UT-së me shkresën me nr.4075 prot., datë 11.09.2018 autorizonte znj.S. B ta përfaqësonte atë; ndërsa pala ankuese ishte personalisht e pranishme. Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e përfaqësueses së Administratorit u depozitua dokumentacion provues lidhur me ekzekutimin e pagesave në favor të ankuses:

- Shkresa me nr.4074 prot., datë 11.09.2018 “Urdhër pagese” nëpërmjet së cilës është urdhëruar pagesa e znj.D. P në cilësinë e anëtarit të KIZ-it, si dhe pagesa e shpërblimit të fundvitit në masën 50% të pagës bruto sipas kategorisë përkatëse. Bashkëlidhur është depozituar dhe dokumentacioni provues për realizimin e këtyre pagesave.

Subjekti ankues, pavarësisht realizimit të kërkesave të natyrës financiare në favor të saj, kërkon nga ana e Komisionerit të konstatojë diskriminimin ana e Administratorit në formën e shqetësimit në vendin e punës, (përmes përmbajtjes së shkresave zyrtare) dhe të marrë masat për ndalimin e këtij shqetësimi. Ajo depozitoi në cilësi prove shkresat e dërguara nga ana e Administratorit drejtuar:

- Rektorit të UT-së. (Shkresa me nr.3317/2 prot., datë 02.08.2018)
- Bordit të Administrimit, Dekanëve të Fakultetit të UT-së (Shkresa me nr.4032/2 prot., datë 07.09.2018 dhe shkresa me nr.4072/1 prot., datë 10.09.2018)
- Rektorit të UT-së (Shkresa me nr.3706/1 prot., datë 02.08.2018)
- Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (Shkresa me nr.4032/2 prot., datë 07.09.2018 dhe shkresa me nr.4072/1 prot., datë 10.09.2018).

¹⁰Në zbatim të Njoftimit me nr.1141 prot., datë 15.08.2018, të Komisionerit.

Në përmbajtje të këtyre shkresave, ndër të tjera citohet se: “...për znj.D. P kërkohet zgjidhja e marrëdhënieve të punës, gjë e cila nuk mund të zgjidhet me revokim vendimi siç keni bërë me shkresën me nr.3664/2 prot., datë 31.07.2018. Nuk ka asnjë mbrojtje gjyqësore me rikthimin në punë për punonjësit e administratës shtetërore që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Rikthimi në punë është vullnet i lirë i palëve që duhet të materializohet në formën e duhur nga ligjore me kontratë të re pune. Vendimi nr.2028, datë 05.03.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka urdhëruar kthim në punë të paditëses. Ajo do të trajtohet me pagë për shkak të procesit të parregullt që keni lejuar të zhvillohet e të pa ankimuar, por, përsa i takon kontratës së punës, ajo duhet të rilidhet në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të administruara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të disfavorshëm të ankueses nga Administratori i UT-së.

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës së znj.D P, rezulton e provuar se ankuesja marrëdhëniet e punës me UT i ka filluar në vitin 2000. Fillimisht ka punuar si Specialiste pranë Rektoratit të UT-së. Më pas, me Vendimin nr.70, datë 17.04.2000 të Rektorit të UT-së është emëruar në detyrën e Kryetares së Degës së Personelit dhe Organizimit. Pas ndryshimeve të ndodhura në strukturën organizative të Rektoratit të UT-së, Dega e Personel-Organizimit ka ndryshuar emërtesën në “Drejtori e Burimeve Njerëzore” dhe ankuesja bazuar në Vendimin nr.103, datë 05.06.2008 të Rektorit të UT-së “Për miratimin e organikës analitike të Rektoratit të UT-së” është emëruar Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (DBNJ). Nga këto akte, rezulton se, znj.D. P ushtron detyrën e Drejtores së DBNJ pranë Rektoratit të UT-së, sipas një marrëdhënie pune të lidhur me Rektorin e UT-së, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të UT-së.

Me Urdhërin nr.8, datë 01.08.2017 të ish-Kancelarit të UT-së, “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës” është urdhëruar zgjidhja e menjëhershme e kontratës së punës së punonjëses, znj.D. P me UT-në.

Me Urdhërin nr.25, datë 23.08.2017 të Rektorit të UT-së, “Për moszbatim të Urdhërit nr.8, datë 01.08.2017 të ish-Kancelarit të UT-së”, është urdhëruar moszbatimi i urdhërit të Kancelarit, si një urdhër i nxjerrë në tejkalim të kompetencave të tij. Rezulton e provuar nga listëprezencat se znj.D. P ka vazhduar të përmbushë detyrat e saj funksionale edhe pas nxjerrjes së urdhërit të ish-Kancelarit të UT-së. Pavarësisht kësaj, ish-Kancelari në cilësinë e nëpunësit autorizues për UT-në, nuk ka kryer as pagesën e pagave të saj.

Mes ish-Kancelarit të UT-së dhe Rektorit ka patur mosdakordësi në lidhje me kompetencat e emërimit të personelit të Rektoratit, gjë që ka çuar në mos kryerjen e pagesës për një periudhë të gjatë të të gjithë personelit të Rektoratit të UT-s dhe jo vetëm të znj.D. P.

Z.S. D është emëruar në detyrën si Administrator i UT-s sipas Vendimit nr.26, datë 07.12.2017 të Bordit të Administrimit (filluar marrëdhëniet e punës në datë 11.12.2017) dhe ka konstatuar situatën e mosdakordësisë mes strukturave drejtuese të UT-së, dhe për këtë fakt ka patur një korrespondencë shkresore mes Rektorit dhe Administratorit për rregullimin e situatës së trashëguar në lidhje me kompetencën për emërimin e personelit të UT-së.

Referuar Vendimit nr.2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (i cili është i formës së prerë) pretendimet për deklarimin absolutisht të pavlefshëm të Urdhërit nr.8, datë 01.08.2017 të Kancelarit të UT-së “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës” dhe detyrimet financiare që burojnë nga zgjidhja e saj, ankuesja i ka ezauruar gjyqësisht. Në vendimin e saj, gjykata ka çmuar se Kancelari i UT-së ka marrë atributet e punëdhënësit duke zgjidhur kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme me znj.D. P. Bazuar në nenin 25 të Statutit të UT-së, Rektori i UT-së është autoriteti më i lartë ekzekutiv dhe urdhërues i UT-së, i cili ka kompetencën për nënshkrimin e kontratave të punës për të gjithë personelin e UT-së. Mbi këtë bazë ligjore është ndërtuar edhe marrëdhënia juridike e punës midis UT-së në cilësinë e punëdhënësit, përfaqësuar nga Rektori dhe punëmarrësit, znj.D. P. Për sa më sipër, Administratori ka cënuar këtë marrëdhënie juridike pune, pasi ai nuk ka kompetencën e punëdhënësit në rastin konkret. E ndodhur para këtyre fakteve, gjykata, në arsyetimin e saj ka çmuar se: *“Konsiderohet tejkalim (abuzim me të drejtën) kur zgjidhja e kontratës është bërë për një motiv abuziv. Si të tilla motivet (shkaqet) abusive, në ndryshim nga shkaqet justifikuese janë të përcatuara shprehimisht në ligj (neni 146 i Kodit të Punës) dhe janë të vetmet në llojin e tyre (motive shteruese)”*.

Përfundimisht, për sa më sipër, gjykata ka vendosur deklarimin absolutisht të pavlefshëm të Urdhërit nr.8, datë 01.08.2017 të Kancelarit të UT-së “Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës për znj.D. P” dhe ka urdhëruar UT-në t’i paguajë ankueses pagën prej muajit Gusht 2017 deri në përfundim të marrëdhënies së punës.

Komisioneri vlerëson se konflikti institucional lidhur me ndarjen e kompetencave mes Rektorit të UT-së, ish-Kancelarit dhe Administratorit aktual rezulton i provuar nga dokumentacioni shkresor i depozituar në dosje dhe është i pranuar nga të dyja palët. (Një fakt i tillë është argumentuar dhe në Vendimin nr.145, datë 02.07.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesën e A.B kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës).

Komisioneri vlerëson se, sjellja dhe veprimet e Administratorit të UT-së ndaj ankueses kanë ardhur si rezultat i faktit që ish-Kancelari i UT-së e ka konsideruar punësimin e znj.D. P nga ana

e Rektorit si të paligjshëm dhe jashtë kompetencave, prandaj dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim si ish-Kancelari, por në vijim pas sqarimit të kompetencave sipas Udhëzimit nr.27, datë 29.12.2017 të MASR, Vendimit nr.2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe shkresës me nr.4074 prot., datë 11.09.2018 “Urdhër pagese” nëpërmjet së cilës është urdhëruar pagesa e znj.D. P në cilësinë e anëtarit të KIZ-it, si dhe pagesa e shpërblimit të fundvitit në masën 50% të pagës bruto sipas kategorisë përkatëse; situata e pagesës së pagave dhe pretendimeve të tjera me karakter financiar të punonjës D. P është zgjidhur dhe nuk ekziston më.

Bazuar në shkresën “Listë emërore për shpërblime të vitit 2017, sipas vendimit të BA nr.27, datë 20.12.2017”, rezulton se shpërblimin e vitit 2017 e kanë përfituar gjithsej 54 punonjës. Nga këta, 20 janë meshkuj dhe 34 janë femra. Pra, nga sa shihet, në dhënien e shpërblimit të fundvitit, gjinia nuk ka shërbyer si kriter favorizues për meshkujt.

Po ashtu, referuar po kësaj liste, aty rezultojnë edhe punonjës të tjerë që kanë statusin e kryefamiljares dhe që kanë përfituar shpërblimin e 2017-ës. Pra, as fakti i të qenurit kryefamiljare nuk ka shërbyer si kriter përjashtues për ankuesen, lidhur me mospërfitimin e shpërblimit të fundvitit.

Komisioneri konstaton se, Administratori i UT-s është njohur me Vendimin nr.2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të cilin konstatohet rregullsisht e marrëdhënieve të punësimit mes Universitetit të Tiranës dhe punonjës D. P dhe detyrimin e UT-së për kryerjen e pagesës së ankueses sipas kushteve të kontratës, nëpërmjet shkresës nr.1136, datë 27.07.2018 të përmbartuesit gjyqësor privat. Komisioneri vlerëson se Administratori i UT-së pas njohjes me vendimin e gjykatës ka marrë të gjitha masat për respektimin e këtij vendimi, brenda afatit të arsyeshëm kohor.

Sa i takon pretendimit të subjektit ankues lidhur me pengimin e ushtrimit të detyrës nga ana e Administratorit, përmes ndërrimit të bravës së zyrës së DBNJ dhe gjithë konfliktin e krijuar për këtë shkak; Komisioneri konstaton se lidhur me sa mësipër është regjistruar një procedim penal lidhur me kallëzimin nr.17184, datë 27.12.2017¹¹ ndaj z.S. D. Pra, sqarimi i këtyre rrethanave dhe vlerësimi i veprimeve të pretenduara të Administratorit mbetet kompetencë e organeve të hetimit.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga

¹¹ Fakt ky i provuar me Vendimin nr.1260, datë 12.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grup personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Administratorit të UT-së, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe trajtimit të pafavorshëm të ankueses.

Ankuesja pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e Administratorit të UT-së, për shkak të gjinisë, gjendjes familjare dhe konfliktit institucional mes drejtuesve të UT-së.

Këto janë shkaqe, për të cilin Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim lidhur me shkaqet sipërcituar, Komisioneri vëren se ankuesja është kryefamiljare (referuar certifikatës familjare, të datës 18.05.2018, lëshuar nga Njësia Bashkiake nr.10, Tiranë, znj.D. P është kryefamiljare, e ve dhe prind i Xh.P, i datëlindjes 16.09.1991).

Gjatë parashtrimeve të saj, ankuesja fokusohet më së shumti tek pasojat që i kanë ardhur nga konflikti i krijuar mes ish-Kancelarit dhe më pas Administratorit aktual të UT-së dhe Rektorit të UT-së. Ky konflikt ka përfshirë edhe subjektin ankues, duke e prezumuar atë si përkrahëse të Rektorit.

Gjatë shqyrtimit të akteve administrative, të depozituara në cilësinë e provës, si dhe duke u mbështetur në Vendimin nr.145, datë 02.07.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me ankesën e A.B kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës, Komisioneri ka konstatuar dhe është vënë në dijeni të konfliktit institucional brenda institucionit të Rektoratit dhe specifikisht konfliktit për kompetencë të Rektorit nga njëra anë dhe ish Kancelarit, Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT, nga ana tjetër. Një fakt i tillë është evidentuar përgjatë korrespondencës zyrtare, që Komisioneri ka patur me të dy titullarët e këtij institucioni, si dhe provave respektive të depozituara nga palët në këtë proces administrativ.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Gjatë shqyrtimit të të gjithë akteve administrative, të depozituara në cilësinë e provës, si dhe duke u mbështetur në korrespondencës zyrtare, që Komisioneri ka patur me të dy titullarët e këtij institucioni (Rektorit dhe Administratorit), rezulton se Administratori i UT-s nuk ka rënë dakord mbi ndarjen e kompetencave të tyre, të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim për shkak të gjinisë dhe gjendjes familjare në lidhje me mospagimin e pagave, dhënies së shpërblimit të fundvitit dhe pagesës si anëtare e KIZ, Komisioneri vlerëson se gjatë shqyrtimit të ankesës së znj.D. P, u administruan prova se ka patur një situatë paligjshmërie nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit, lidhur me mos pagimin e pagave të saj, të konstatuar si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më anë të Vendimit nr.2028, datë 05.03.2018 të saj; por nuk u siguruan prova apo informacion për të provuar se mos pagimi i pagave dhe dhënia e shpërblimit të fundvitit nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit është bërë për shkak të gjinisë apo qënies si kryefamiljare të ankueses. Theksojmë faktin se këto pagesa (sikurse është cituar dhe më lart në vendim) janë ekzekutuar nga ana e Administratorit, gjatë periudhës që ankesa ishte në shqyrtim nga Komisioneri.

Bazuar në shkresën “Listë emërore për shpërblime të vitit 2017, sipas vendimit të BA nr.27, datë 20.12.2017”, rezulton se shpërblimin e vitit 2017 e kanë përfituar gjithsej 54 punonjës. Nga këta, 20 janë meshkuj dhe 34 janë femra. Pra, nga sa shihet, në dhënien e shpërblimit të fundvitit, gjinia nuk ka shërbyer si kriter favorizues për meshkujt. Ankuesja nuk është dizavantazuar për këtë shkak.

Po ashtu, referuar po kësaj liste, aty rezultojnë edhe punonjës të tjerë që kanë statusin e kryefamiljares dhe që kanë përfituar shpërblimin e 2017-ës. Pra, as fakti i të qënurit kryefamiljare nuk ka shërbyer si kriter përjashtues për ankuesen, lidhur me mospërfitimin e shpërblimit të fundvitit.

Përsa i takon pretendimit për shqetësim në marrëdhëniet e punës nga ana e Administratorit të UT-së, Komisioneri konstaton se, Administratori i UT-së është njohur me Vendimin nr.2028, datë 05.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet shkresës nr.1136, datë 27.07.2018 të përmbaruesit gjyqësor privat. Komisioneri vlerëson se Administratori i UT-së pas njohjes me vendimin e gjykatës ka marrë të gjitha masat për respektimin e këtij vendimi, duke e ekzekutuar atë, brenda një afati të arsyeshëm kohor. Përsa i përket pretendimit të ankueses lidhur me shqetësimin në vendin e punës nga ana e Administratorit të UT-s, shprehur përmes përmbajtjes së shkresave zyrtare dërguar në adresë të Rektorit të UT-së, Bordit të Administrimit të UT-së dhe Ministres së Arsimit, Rinisë dhe Sportit; Komisioneri vlerëson se një qëndrim i tillë i Administratorit të UT-së në thelb nuk përmban elementë që do të mund të konsideroheshin si shqetësim në vendin e punës, në kuptim të interpretimit që LMD ka për këtë formë diskriminimi. Opinioni personal i Administratorit lidhur me paligjshmërinë e emërimit të ankueses në këtë pozicion pune dhe delegimi i këtij shqetësimi (sipas bindjes së tij) organeve të tjera kompetente,

nuk ka të bëjë me vendimmarrjen e tij lidhur me këtë pozicion pune, por me mënyrën se si ai e argumenton paligjshmërinë e saj si Drejtore e DBNJ pranë UT-së dhe delegimin për zgjidhje organeve të tjera vendimmarrëse.

Në nenin 3/1 të ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në nenin 3/5 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”.*

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashtrohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se, punonjësja D. P është nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi diskriminues në formën e shqetësimit nga ana e Administratorit të UT-së, për shkak të konfliktit të krijuar mes Rektorit dhe Administratorit të UT-së dhe prezumimit të saj nga ana e Administratorit si përkrahëse e Rektorit. Nuk kemi cënim të nenit 3/1, 3/5, 7/1 të LMD-së.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1.** Konstatimin e mosdiskriminimit të znj.D. P nga ana e Administratorit të UT-së, për shkak të gjinisë, të gjendjes familjare apo në formën e shqetësimit të saj prej tij, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Gjini, Gjendje familjare, Çdo shkak tjetër